

BESARTA QALLIAJ

RASA RRJEDHORE NË PROZËN E E. KOLIQIT

Proza e Koliqit na ka tërhequr vëmendjen edhe në një rrafsh pak të trajtuar: në atë të paradigmes së lakimit. Brenda kësaj paradigme ne kemi parë larmi përdorimesh të rasës rrjedhore, me parafjalë dhe pa parafjalë. Materiali i gjetur është interesant edhe në rrafshin sintaksor gjuhësor, por edhe në atë letraro-artistik. Shohim se në varësi nga përdorimi me ose pa parafjalë i kësaj rase, proza e Koliqit fiton intensitet dhe zhdërvjellësi të niveleve të ndryshme, sa shpesh kthehet në prozë poetike.

Rasa është një nga kategoritë gramatikore të trajtuara gjerësisht dhe në nivelin më të lartë shkencor këtë e gjen në *Gramatikën e gjuhës shqipe*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Rasa del si një ndër kategoritë gramatikore kryesore të emrit është. Në literaturën gjuhësore në shqipe ka pasur diskutime për çështjen e numrit të rasave dhe të kufijve të rasave. Po në këtë studim ne do të ndalemi në ato çështje të rasave që janë të pranueshme.

Kur flasim për rasën si kategori gramatikore kemi parasysh dy anë të saj: *formën e caktuar* të emrit dhe *kuptimin gramatikor* që shpreh. Emrin ndryshon formën e tij, duke u përdorur në funksione të ndryshme sintaksore.

Siç dihet rasa tregon ose zbulohet përmes formës së emrit, me anën e së cilës shprehet lidhja e tij me gjymtyrët e tjera të fjalisë.

Kuptimi gramatikor, përgjithësisht, identifikohet përmes një funksioni të caktuar sintaksor të një emri të dhënë. Kështu, në fjalinë “*Rinia vazhdon traditën e bukur të shkollimit*”, emrat rinia, traditën, të shkollimit kanë forma të veçantë morfologjike dhe shprehin përkatësisht funksionet sintaksore të kryefjalës, të kundrinorit dhe të përcaktorit.

Emri është njësi leksiko-gramatikore e eptueshme, d.m.th. e lakueshme. Të lakosh një emër do të thotë ta çosh atë nga një rasë në një tjetër. Në gjuhën shqipe lakohen të gjithë emrat, duke përfshirë edhe emrat e huaj¹.

¹ Shih më gjerë *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, pjesa “Lakimi i emrave”, Tiranë, 2002.

Emrit sot i njihen pesë rasa: emërore, gjinore, dhanore, kallëzore dhe rrjedhore². Për të përcaktuar numrin e rasave duhet të mbështetemi në sasinë e formave rasore të veçanta si dhe në funksionet sintaksore. Gjuha shqipe, ndonëse ka pesë rasa, nuk ka forma të veçanta për pesë rasat. Në qoftë se marrim një emër dhe e lakojmë, do të shohim se ai nuk del me më shumë se katër forma të veçanta gramatikore. Kështu në njëjës in e pashquar: ekzistojnë tri forma. Konkretisht: 1. Emërore dhe kallëzore (mal) 2. Gjinore (i/e mal-i), 3. Dhanore e rrjedhore (mal-i); në njëjës të shquar ka katër forma të veçanta gramatikore: 1. Emërore (mal-i), 2. Gjinore (i/e malit), 3. Kallëzore (mal-in), 4. Dhanore dhe rrjedhore (mal-it); shumës in e pashquar: 1. Emërore dhe kallëzore (male), 2. Gjinore (i/e male-ve), 3. Dhanore (male-ve), 4. Rrjedhore (male-sh); në shumës të shquar ka tri forma të veçanta gramatikore: 1. Emërore dhe kallëzore (malet), 2. Gjinore (i/e maleve), 3. Dhanore dhe rrjedhore (maleve).

Pra, në qoftë se do të bazohemi në tipa të veçantë lakimi, do të pranim e shumta katër rasa për emrin në gjuhën shqipe. Në këto rrethana përcaktimi i numrit të rasave bëhet në rrugën e kundërvënies së formave që kanë emrat e grupeve të ndryshme, duke e parë problemin e rasave si një sistem të plotë, në njëjës të pashquar dhe të shquar, në shumës të pashquar dhe të shquar.

Nga kjo kundërvënie vihet re se përveç emërores (lis-i) gjinores (i/e lis-it), dhanore (lis-it), duhen konsideruar rasa më vete edhe kallëzorja (lis-in) si dhe rrjedhorja (lisa-sh). Nga sa shihet edhe më lartë, emri del gjatë lakimit (si sistem) në pesë forma të veçanta gramatikore.

Ndarja e gjinores si rasë e veçantë bazohet jo vetëm në anën kuptimore, por edhe në praninë e nyjës, e cila e shoqëron gjithnjë këtë rasë (libri i nxënësit) dhe e dallon nga ana formale prej dhanores, që përndryshe paraqitet e njëjtë me të. Duke qenë pjesë përbërëse e formës së rasës gjinore, kjo nyjë, megjithatë, në përpjekje të përshtatjes gramatikore shkon

² **Shënim: 1.** Më parë, në disa gramatika është marrë si rasë e veçantë rasa thirrore. Ajo nuk ka mbaresa të veçanta, por përdoret kryesisht në trajtën e pashquar. E vetmja shenjë e jashtme është e kësaj rase është pjesëza “O” që i vihet përpara, veç kësaj është edhe kuptimi i veçantë i saj (**O trim**, më thuaj se kush je). Duke qenë se thirrja nuk ka formë të veçantë që t’u kundërvihet rasave të tjera dhe pjesëza “O” here vihet herë jo, për këtë arsye është hequr nga sistemi i rasave të shqipes dhe merret si emërore. 2. Në gjuhën shqipe nuk ka formë të veçantë për të ashtuquajturën rasë vendore. Ekzistojnë disa trajta me mbaresën –t, si në fikt, në kanalt etj. Këto forma kanë mbetur dialektore dhe gjuha standarde shqipe nuk i ka pranuar, pasi sot përdoret në fik, në kanal.

me fjalën paraprirëse d.m.th. trajtat e saj të eptimit sipas gjinisë, numrit dhe rasës së emrit të përcaktuar.

Siç vërehet, një gjë është pranuar nga të gjithë se në lakimin e shqipes ka dy aspekte të ndryshme, aspekti i caktuar dhe i pacaktuar. Kjo do të thotë se format e rasave të shqipes janë dyfishuar. Kështu, në vend që të kishim vetëm dy trajta të emërores, një njëjës dhe një shumës, kemi në fakt katër trajta, dy për njëjës (të caktuar dhe të pacaktuar) dhe dy për shumës (të caktuar dhe të pacaktuar). Kjo nga njëra anë e ndërlikon problemin, sepse konceptit origjinar të rasës si shprehje raporti vjen e i shtohet edhe koncepti i shquarsisë. Por, nga ana tjetër, dallimi dhe veçimi i rasave bëhet edhe më i lehtë, sepse opozicionet formale shtohen, ndërkohë që koncepti bazë i rasës mbetet po ai.

Së pari, duke i trajtuar rasat si kategori gramatikore, ne do të marrim në shqyrtim edhe formën, edhe përmbajtjen, duke pasur parasysh për këtë të fundit kuptimin gramatikor themelor të kësaj apo asaj rase të veçantë.

Së dyti, duke i trajtuar rasat si përbërëse të një sistemi të vetëm, ne do t'i vështrojmë ato të lidhura me njëra-tjetrën. Kjo lidhje përshkon si njëjës dhe shquar e të pashquar, ashtu edhe shumës dhe shquar e të pashquar, por në shumës ajo vjen e dobësohet, sepse opozicioni formal në këtë numër midis dy trajtave, trajtës së shquar dhe të pashquar, gjymtohet për shkak të rënies së treguesit të dikurshëm të shquarsisë -t pas trajtave me mbaresën -ve.

Megjithëse përbëjnë dy koncepte të ndryshme, rasa dhe shquarsia në gjuhën shqipe ato janë të lidhura ngushtë me njëra – tjetrën. Por nga ana tjetër duhet theksuar, që kundërvënja trajtë e shquar – trajtë e pashquar nuk është absolute, në kuptimin që ta mbulojë kundërvënien rasore një për një. Me fjalë të tjera, nuk është e thënë që numri rasave në të dy trajtat të përputhet. Këtë gjë e pati vënë re, ndër të tjerë, edhe S. Frashëri, i cili në gramatikën e tij (“Shkronjëtores e gjuhës shqip”, 1886) rrjedhoren (mërgonjëtores, siç e quan ai) nuk e shënon si rasë në paradigmen e trajtës së shquar, duke u shprehur qartë se ajo është vetëm e pashquar.

Së treti, homonimia e trajtave, apo më saktë e mbaresave, duhet pranuar vetëm në rrafshin ndërsistemor, d.m.th. brenda sistemit paradigmatic të lakimit, midis nënsistemeve të tij, e jo tek e njëjta hallkë e të njëjtit nënsistem.

Së katërti, parimi i ndarjes duhet të jetë homogjen, d.m.th i njëjti parim duhet zbatuar në të gjitha rastet. Kur vështrohet forma e rasave, duhet të kemi parasysh mbaresën, sepse rasat e shqipes vetëm nga mbaresat mund t'i dallojmë. Treguesit e tjerë të jashtëm, qofshin morfologjikë, qofshin

sintaksorë, nuk janë përcaktues. Fjala këtu është për rasën gjinore, e cila, jo si rasat e tjera, në aspektin formal dallohet vetëm nga prania e nyjes, përndryshe është e barabartë me dhanoren. Ndryshe e vështron këtë gjë Oda Buchholz, e cila mendon se “në gjuhën shqipe përveç mbaresave kemi në dispozicion edhe mjete të tjera me anën e të cilave mund të dallohen rasat”. Sipas saj, “në këto mjete gjuhësore bëjnë pjesë nyja e përparme³ shënuesi i dhanores⁴ dhe shënuesi i kundrinës së drejtë.”⁵ Por sipas studiuesit F. Agalliu, kjo nuk mund pranohet.⁶ Nyja e përparme dhe trajta e shkurtër e dhanores u takojnë dy kategorive krejt të ndryshme. Për më tepër, i ashtuquajturit shënues i dhanores ka kuptim përemëror, sepse krahas përdorimit *djalit i..... ose djemve u.....* kemi edhe përdorimin *i tha ose u tha*, kështu që nuk mund të përfshihet as në kategorinë e morfemave, as në atë fjalëzave morfema.

Në këto vite që nga libri i parë shqip që njohim, sistemi i lakimit të gjuhës shqipe është thjeshtuar, sepse është zhdukur rrjedhorja e shquar e shumësit me *-shit* dhe bashkë me të krejt kjo rasë në aspektin e shquar, se rasa vendore mbeti si formë dialektore e nuk zuri dot vend në shqipen standarde dhe se në anën tjetër, drejtimi i parafjalëve erdhi e u përqendrua në dy rasa, në dhanoren e kallëzoren. Ne kemi vjelë të tërë veprën letrare të Ernest Koliqit edhe në këtë rrafsh, për të hartuar pasqyra të paradigmave të lakimit të emrave në këtë vepër. Por, duke u nisur nga hapësirat e kufizuara që krijon kumtimi në një veprimtari shkencore si kjo e sotmja, në këtë shkrim, gjithashtu, jemi përpjekur të japim vetëm një pasqyrë të disa përdorimeve të rasës rrjedhore në veprën e Koliqit, duke i dhënë materialit që kemi në dorë natyrën e një trajtese të përzier mofosintaksor mbi një nga rasat më problemore në sistemin e lakimit të shqipes.

Kupa qiellore përkulej gëzueshëm mbi at skutë të blertë, tretë midis maleve.

Fryma e flladeve mbushte ajrin me dridhje të freskta e përhapte një âme të shëndoshë mendre t'egër e sherbelash.

Pataloku para famullis u mbulue me grumbuj Malsorësh e Malsorësh, veshë në petka feste.

³ E ka fjalën për rasën gjinore.

⁴ D.m.th. trajtën e shkurtër.

⁵ Shih; Oda Buchholz, *Mbi gërshetimin e aspekteve morfologjike e sintaksore tek rasat në gjuhën shqipe*, në “Gjurmime albanologjike”, VII – 1977, f. 147-148.

⁶ Shih F. Agalliu, *Sa rasa ka emri? në botimin Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1988, f. 116-117.

*Pleqt, me t'ecun të matun e plot madhni, fytyrën e rrethueme **shallash** bardh si bora, kërkuen hijet e lisave dhe u shtruen rrotull me bâ kuvënd tue pí duhan.*

*Djelmoshat, me kapuç **leshit** në krye, kapën mauzerret, qi sa ngjati mesha kishin ndëjë të varuna tu dera e kishës, e kaluen teposhtë kah logu i shëjit. Të gjatë e të zhdërvjellët, çakçirët e bardhë me gajtana të zez e të shëndritshëm, me rryma **fyshekësh** të ngjeshur për bel, tue ecun të lehtë e të shpejtë mbi bar të butë, me armë në dorë, m'u dukshin çetë **heronjsh** e dalun prej ndonji poemi epik.*

*Granija delte prej **kishe** tue bâ kryq papushue e tue puthë medajat e rruzareve. (E. Koliqi, Vepra 2... f. 9)*

*Kumbonza e kumbunares së vogël dha lajmin e mbarimit të meshës. Bashkë me tingëllat e qartat saj, u shpërdanë nëpër ledinë të gjelbër gjint qi delshin prej **kishet**.*

Edhe un, me Dom Markun, famulltarin e vëndit në shtëpín e të cilit kisha rá mik, u avita me pá.

*Arrijtëm shi n'at ças kur njâni prej **shëjtarve** po futej në mes të shokvet tue thânë me krení.*

Djaloshi u shtrí në bar, rراسi kapuçin për krye dhe e sznoi shëjin kadalë. (E. Koliqi, Vepra 2... f. 10)

*Pirolla të kjoftë! Veshë si tjerët, por me një kujdes mâ të veçantë, kishte në të gjitha sjelljet një zhdërvjellti, qi e bante m'u dallue **shokësh**. (E. Koliqi, Vepra 2... f. 10)*

*Shtrihët përmbys buzë **zgripit** të kronit, ulë buzët e etëshme kah uji e merr me pí, kur, e papritun, një gojë e kuqe, e freskët, lulzon për mrekulli si drandofille mbi pasqyrë të gurrës, e puthë gjatë, dashunisht, e zhduket.*

Kthen në shtëpi mëndueshëm.

*Dy a tri herë desht m'u çue e me dalë jashtë, i ngrehun prej **dy zânave** të mshefta, por një frigë e pakuptueshme qi i a shtrëngonte **zêmre** e bâni m'u ndalë.*

*Opângat rrëshqitëshin mbi bar të rímë prej **voesës**.*

*Balat lëshoheshin përpara gëzueshëm tue lehë e tue nuhatë. Ai kapërcente prroje e ograia baltanike, përshkohej nëpër çufra e murriza, u binte për tërthuer **prozhmeve** të dënduna e lugjeve të ndritëshme. Sa i kaloi habija e parë, gjuetari joshi qënt idhnueshëm, i nxiti e i u vû mbrapa me tânë shpejtín qi kishte. (E. Koliqi, Vepra 2... f. 14)*

Siç u pa edhe nga materiali që kemi sjellë nga vepra e Koliqit themi edhe një herë se emri në gjuhën shqipe ka së shumti katër rasa (për të

pashquarën). Në trajtën e shquar ky numër zbret në tre, sepse rrjedhorja mungon në këtë trajtë, meqenëse është zëvendësuar nga dhanorja.

BIBLIOGRAFI

Kolliqi, E., *Vepra* 2, 3.

Agalliu, F., *Sa rasa ka emri?* në botimin “Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe”, Tiranë, 1988.

Agalliu, F., *Rrjedhorja si një rasë me vlerë jo të plotë në gjuhën shqipe*, SF, nr. 3, 1989.

Agalliu, F., *Rreth përdorimeve të rrjedhore në shqipen e sotme letrare*, SF, nr. 1, 1990.

Demiraj, Sh., *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1972.

Gosturani, Xh., *Rasa rrjedhore apo gjinore?* SF, nr. 3, 1989.